



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Opsteg Sekretara/Office of the General Secretary*

|                               |  |
|-------------------------------|--|
| <b>DATË/A:</b>                | 16.01.2019   |
| <b>REFERENC-Ë:</b>            | 6184-2/18 ZSP ARPL 2019  |
| <b>PËR/ZA/TO:</b>             | "CONTOUR GLOBAL KOSOVO" L.L. C., Rr.<br>Anton Çeta 5A Prishtinë, Kosovë              |
| <b>CC:</b>                    |  |
| <b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>  |  |
| <b>NGA/OD/FROM:</b>           | Arben ÇITAKU, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së                                      |
| <b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b> | Kushte Ujore ( për hartimin e dokumentacionit<br>tekniko- investiv për Pëlqim Ujor ) |

Sipas kërkesës tuaj me nr. të protokollit 6184-2/18, organi kompetent i MMPH-së ka shqyrtuar lëndën dhe ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letër përcjellëse :

"Me respekt"

Faqe 1 nga 4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Opsteg Sekretara/Office of the General Secretary

Bazuar në nenin 71 të Ligjit Nr.04/L-147 dhe nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nxjerrë këtë:

**Kushte Ujore**


( Për hartimin e dokumentacionit-tekniko investiv për Pëlqim Ujor )

Pas shqyrtimit të dokumentacionit - informata shtesë për plotësimin e Kushteve Ujore të parashtruar nga „CONTOUR GLOBAL KOSOVO” L.L.C., K. Prishtinë, lidhur me shfrytëzimin e ujit për termocentralin Kosova e Re, nga Kanali Iber – Lepenc, hidrosistemi që rrjedhë nga Liqeni i Ujëmanit ( Gazivodës ) deri në qytetin e Prishtinës, janë plotësuar kushtet ujore dhe,

**Pala aplikacionit për Pëlqim Ujor duhet t’i bashkangjes dokumentacionin si në vijim:**

1. Kopja e vërtetuar e certifikatës së biznesit;
2. Kopje e vërtetuar e certifikatës së numrit fiskal;
3. Dëshmi mbi pagesën e tarifave administrative ;
4. Autorizimi i mbi përfaqësimin e aplikuesit duhet të vulozet nga të dyja palët;
5. Vendimi i lëshimit të Kushteve Ujore, Pëlqimit Mjedisor dhe Kushteve Ndërtimore ( Pëlqimin Urban) ;
6. Leja e Operatorit të sistemit të ujësjellësit, nëse ka një të tillë.
7. Që “Raporti i Projektimit Ideor për Kushte Ujore për shfrytëzimin e ujit “ të titullohet “ Dokumentacioni tekniko – investiv për Kushte Ujore për shfrytëzimin e ujit”
8. I tërë dokumentacioni lidhet, vërtetohet, dhe në tri kopje të forta dhe një kopje soft CD, dorëzohet në arkivin e MMPH-së;
9. Kushteve ujore ju skadon afati i vlefshmërisë pas një ( 1 ) viti, për të cilat nuk është paraqitur kërkesë për Pëlqim Ujor;

Faqe 2 nga 4




Poashtu gjatë shqyrtimit të kërkesës në Gazetën ditore “Bota Sot” e ditës së Shtunë dhe e Dielë të datës 22,23 Dhjetor 2018, është bërë shpallja për njoftimi publik, për pjesmarrjen e publikut në procedurat e akteve ujore, me afat 7 ditë, nga dita e publikimit në Gazet ditore. Gjatë këtijë afati nuk kemi pas asnjë reflektim lidhur me çështjen.

Pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë, shikimit në vend, me datë 02.11.2018, ARPL-ja , përfaqësuesit të Kompanise “Eko Iliria“ sh.p.k. dhe “Iber-Lepenci”sh.a., legjislacionit primar e sekondar dhe konstatimeve si me sipër, është vendosur si në dispozitiv të këtijë vendimi.

### ARSYETIM

Pala „CONTOUR GLOBAL KOSOVO”, L.L.C., K. Prishtinë, pas kërkesës për informata shtesë, me nr protokoll. 6184-2/18, datë 18.12.2018, ka sjellë dokumentacion për kushte ujore për shfrytëzimin e ujit për Termocentralin Kosova e Re, nga Kanali, Iber – Lepenc, hidrosistemi që rrjedhë nga Liqeni i Ujëmanit ( Gazivodës ) deri në qytetin e Prishtinës. Aplikuesi kërkesës ia ka bashkangjitur këtë dokumentacion investivo-teknik:

- Fleten e pare të kërkesës për informata shtesë, m nr protok. 6184-2/18, datë 05.12.2018 ;
- Certifikata e regjistrimit të biznesit, “Contour Global Kosovo” L.L.C. ;
- Informimin nga “Contour Global Kosovo” L.L.C. për kontratën me “Eco-Iliria” për aplikim për Kushte Ujore dhe dhe Pëlqim Ujor për TC “Kosova e Re “ për shfrytëzime të ujit;
- Plani i situacionit, me përpjesë 1:1000 , punuar nga Izjah Qerkini , inxh i gjeod. , vërtetuar nga Rrustem BEKAJ , Departamenti i i Gjeodezisë Inxhinierike – KEK;
- Orto foto me prezantimin e kanalit të ujit të I-L dhe koridorit furnizues të ujit;
- Raporti i prjektimit ideor për kushte ujore;
- Ekstrakt nga Certifikata – personi KEK – Sh.a.
- Diploma dhe CV e personit hartues, Inxh i Dipl i Nder. Drejtimi hidro, znj Violeta HOXHA;
- Projekti i Termocentralit Kosova e Re, bllok me linjit X500 MW;
- Marrëveshjen në mes të “Contour Global” dhe “Iber Lepenci” (19 Shkurt 2018 )
- CD-në.



## KËSHILLA JURIDIKE:

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në iniciimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr: 6184-2/18 - ZSP- 14 Datë: 22.01.2019

Prishtinë

### T'i dërgohet :

1. Palës,
2. Kabinetit të Ministrit,
3. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
4. K. Obiliq,
5. Inspektoratit,
6. ARPL-së,
7. Arkivit të Ministrisë.

Sekretar i Përgjithshëm



Arben ÇITAKU